

MBI AUDITIMIN E PERFORMANCËS TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të Performancës të ushtruar në **Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Tiranë**, me objekt: “*Shkeljet në fushën doganore dhe sanksionet e zbatuara*” dhe rekomandimet për masat që duhen marrë, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 46, datë 2/4/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 510/11, datë 14/09/2012, **dërguar Z. Flamur Gjymishka, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave**, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka përsa më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Administrata Doganore në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe strukturat ligjvënëse të përmirësojnë legjislacionin doganor, veçanërisht në pjesën VIII të tij “Shkeljet në fushën doganore dhe sanksionet” të Kodit Doganor, dhe ta përfshijë atë në Dispozitat Zbatuese dalë në zbatim të tij, kryesisht sipas drejtimeve të përcaktuara më poshtë:

- Nëpërmjet ndarjes së qartë të përcaktimit të kundërvajtjes administrative dhe kontrabandës në Kodin Doganor, si dhe përputhja e tyre me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Administrative.
- Në vendosjen e penaliteteve sa më të sakta, edukuese, parandaluese dhe të arkëtueshme, si dhe krijimin e procedurave garantuese të pagesës së këtyre penaliteteve.
- Në krijimin e procedurave të thjeshtuara të verifikimit të kundërvajtjeve administrative e të kontrabandës.
- Në përcaktimin më të qartë të procedurave që duhet të ndjekin punonjësit në dogana.
- Në drejtim të ndjekjes së zbatimit të afateve të fillimit të procedurave për vjeljen e detyrimeve dhe të transferimit të dosjeve.
- Në drejtim të përmirësimit të procedurave të apelimit.

Në vazhdim

2. Administrata doganore mbështetur në legjislacionin doganor, në mënyrë të programuar t’i kryejë të gjitha reformat e domosdoshme tekniko-profesionale konform kërkesave të legjislacionit, ato duhet të jenë të motivuara, për të bërë të mundur rritjen e efektivitetit të punës së tyre.

Vazhdimisht

3. Administrata doganore mbështetur në legjislacionin doganor, në mënyrë të veçantë duhet të kryejë trajnime për pjesën e VIII të Kodit Doganor “Shkeljet në fushën doganore dhe sanksionet”, me qëllim ngritjen e vazhdueshme profesionale për formimin, ngritjen dhe përmirësimin e njohurive të çdo

punonjësi, që të jenë të aftë t'u përgjigjen kërkesave në zhvillim të profesionit dhe të sfidave me të cilat përballet administrata doganore.

Vazhdimisht

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit z. Livan Hoxha Përgjegjës Grupi, z. Alfred Zylfi dhe z. Sali Agaj, anëtarë. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit z. Kristaq Gjurgjaj i komanduar Drejtor Departamenti dhe Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë zj. Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT